



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 18, DATË 02.03.2017

**PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 117 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA	
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ	
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ	
	Gledis	GJIPALI	
	Piro	MISHA	
	Suela	MUSTA	
Zylyftar		BREGU	



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
Tel. & Fax. +35542227745
Rr. "Ismail Qemali", Nr.11, Tiranë

Nr. 315 prot.

Tiranë, më 31.2017

LËNDA: *Dërgimi i kontratës së rishikuar të shërbimit të transmetimit publik RTSH - AMA*

DREJTUAR: **Z. GENTIAN SALA**
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

(Adresa: Rruga "Abdi Toptani", 1001, Tiranë)

I nderuar Z. Sala,

Në zbatim të nenit 117, të ligjit nr.97/2013, datë 04.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Drejtues RTSH me vendimin nr.18, nr.prot.317, datë 31.01.2017 ka miratuar kontratën e rishikuar të shërbimit të transmetimit publik mes RTSH dhe AMA, pas sugjerimeve të dërguara nga institucioni juaj me shkresën nr.prot. 3529/1, datë 07.12.2016, protokolluar me tonën me nr.prot.3610/2, datë 09.12.2016.

Pas miratimit nga Këshilli Drejtues RTSH, kjo kontratë është firmosur në dy kopje origjinale nga Drejtori i Përgjithshëm RTSH dhe me anë të kësaj shkrese po ua dërgojmë edhe ju për nënshkrim, në respektim të pikës 3 të nenit 117 të ligjit nr.97/2013.

Pas nënshkrimit nga ana juaj, ju lutem një kopje origjinale të firmosur nga të dyja palët të na e dërgoni në adresën tonë zyrtare:

Radio Televizioni Shqiptar
Rruga "Ismail Qemali", Nr.11
1005, Tiranë, Shqipëri


Bashkangjitur do të gjeni dy kopje të firmosura të kontratës së sipërcituar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM RTSH

Thoma GËLLÇI

Thomylli





AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

390/1
03/02/2017



KONTRATË E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT PUBLIK

E lidhur sot më, datë ___/___/2017, me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar, midis palëve:

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE, me seli në Tiranë, rruga "Abdi Toptani", përfaqësuar nga Kryetari, Z.Gentian SALA, që më poshtë do t'i referohemi si **AMA**.

dhe

RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR, me seli në Tiranë, rruga "Ismail Qemali", Nr.11, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, Z. Thoma GËLLÇI, që më poshtë do t'i referohemi si **RTSH**.

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i parimeve dhe veprimtarive që RTSH merr përsipër të realizojë, për të përmbushur detyrimet e vendosura në ligjin nr.97/2013, datë 04.03.2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikëne Shqipërisë", në kuadër të realizimit të qëllimit për të cilin është krijuar dhe funksionon, si një transmetues publik në garantimin e shërbimit të nevojshëm e të përshtatshëm për publikun shqiptar.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet bazuar në ligjin nr.97/2013, datë 04.03.2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenit 117 në veçanti, VKM nr.466, datë 27.02.2015 "Për miratimin e planit të frekuencave", aktet ligjore e nënligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3 Parimet

Parimet kryesore që respekton dhe mbi të cilat mbështetet RTSH gjatë veprimtarisë së saj për ofrimin e shërbimit të transmetimit të programit audio dhe audioviziv për publikun janë:

- Parimi i garantimit të transmetimit audio dhe audioviziv.
- Parimi i ndalimit të censurës paraprake gjatë komunikimit me anë të transmetimeve audio apo transmetimeve audiovizive duke siguruar akses për të gjithë ata që duan të përfitojnë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.
- Parimi i garantimit të lirisë së shprehjes dhe informimit si një nga parimet kryesore të lirisë dhe të drejtave të individit në Republikën e Shqipërisë.
- Parimi i lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe burimeve gjatë transmetimit me mjete të komunikimeve audio dhe audiovizive.
- Parimi i ligjshmërisë gjatë realizimit të qëllimit të veprimtarisë së RTSH-së.
- Parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë editoriale gjatë transmetimeve audio dhe transmetimeve audiovizive.
- Parimi i respektimit të paanshmërisë në bindjet politike dhe besimeve fetare të publikut.
- Parimi i respektimit të personalitetit, dinjitetit dhe jetës private të njeriut.
- Parimi i respektimit dhe i mbrojtjes të të drejtave, interesave, kërkesave morale e ligjore të të miturve.
- Parimi i mosçenimit të rendit kushtetues, sovranitetit dhe integritetit kombëtar gjatë veprimtarisë audio dhe audiovizive.
- Parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë së individëve për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, kombësia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, aftësia e kufizuar apo anëtarësisë në sindikata.
- Parimi i respektimit të kulturës dhe gjuhës shqiptare si dhe të standardit letrar të saj.
- Parimi i respektimit të të drejtave kushtetuese të pakicave kombëtare në përputhje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.
- Parimi i paraqitjes objektive dhe të paanshëm të informacionit për publikunduke respektuar kështu formimin e lirë të opinionit të tij.
- Parimit të moslejimit të transmetimeve që nxisin dhunën dhe intolerancën ndërmjet shtetasve.
- Parimi i të drejtës për të dhënë përgjigje për informacionet e kërkuara.
- Parimi i respektimit të fqinjësisë së mirë midis popujve.
- Parimi i garantimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.
- Parimi i garantimit të integritetit të çështjeve gjinore, LGBT dhe të rinjtë.

Neni 4

Qëllimet kryesore të RTSH-së

Në arritjen e qëllimeve kryesore, veprimtaria e RTSH-së do të fokusohet në:

- a) Transmetimet audiovizive duke ju përgjigjur interesave dhe kërkesave të të gjithë popullatës, duke pasur në vëmendje garantimin e mirëkuptimit dhe paqes në Republikën e Shqipërisë e më gjerë, duke siguruar që programet e veta të pasqyrojnë elementet e ndryshme njerëzore dhe kulturore dhe në vecanti duke i kushtuar vëmendje të veçantë elementeve dalluese të kulturës kombëtare dhe gjuhës shqipe, argëtimit dhe edukimit të publikut.



- b) Transmetimet audiovizive të cilat do të bëjnë të mundur informimin e publikut dhe kuptimit nga ana e tij të vlerave dhe traditave të vendeve të tjera, në veçanti ato europiane;
 - c) Transmetimet audiovizive të cilat do të bëjnë të mundur mbulimin e pasqyrimin të veprimtarive sportive, fetare e kulturore.
 - d) Transmetimet audiovizive të cilat do të bëjnë të mundur pasqyrimin e programe me lajme dhe çështje aktuale, në vend dhe jashtë, përfshirë mbulimin e veprimtarive parlamentare;
 - e) Ofrimin e shërbimit të teletekstit si dhe ofrimin e informacionit nëpërmjet faqes së internetit, në lidhje me shërbimet e veta që mundëson, ku dhe do të sigurojë përditësimin dhe mirëmbajtjen e kësaj faqeje.
 - f) Në mirëmbajtjen e Orkestrës Simfonike të RTSH-së dhe të kujdeset që roli i saj në edukimin dhe zhvillimin e jetës artistike të jetë në nivele të larta profesionale.
 - g) Në bashkëpunimin me institucione të ndryshme publike, që në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, të mundësojë përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit përkatës për publikun.
 - h) Në angazhimin e saj me përkushtim dhe seriozitet në dixhitalizimin e arkivave të saj si dhe në mirëmbajtjen e materialeve të cilat janë një pasuri kombëtare e që lidhen ngushtësisht me arritjen e qëllimeve gjatë veprimtarisë së saj.
- Në krijimin dhe vënien në funksion të shërbimeve të transmetimeve lokale apo rajonale, për kategori ose grupime të ndryshme shoqërore, të cilat do të jenë pa pagesë.

Neni 5

Rrjeti i transmetimevetë RTSH-së

RTSH do të të ngrejë, do të mirëmbajë dhe do të vërë në funksionim stacione të transmetimit numerik për përdorimin e rrjeteve të komunikimit elektronik, si dhe shërbimin kombëtar të transmetimeve audio dhe audiovizive të veta nëpërmjet multiplekseve.

Ky do të jetë një shërbim transmetimi kombëtar pa pagesë për publikun dhe i kapshëm, për aq sa është e mundur, nga të gjithë shtetasit në Republikën e Shqipërisë dhe shqiptarët jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Katalogu i Programeve

Në përputhje me detyrimet ligjore, kërkesat e publikut, standardet bashkëkohore, kushtet teknologjike dhe mjetet financiare në dispozicion, RTSH do të bëjë të mundur, që brenda afatit 5-vjeçar të kësaj kontrate, të ofrojë **4 (katër) programe HD dhe 8 (tetë) programe SD**, prodhime të vetë RTSH, sa më poshtë vijon:

1. RTSH 1 (HD)

Kanali gjeneralist kryesor me shtrirje dhe interes të gjerë. Fokusi i tij do të jetë trajtimi i temave kryesore të jetës së vendit, larmi programesh për të gjitha moshat, gjinive të ndryshme televizive, përgatitja e emisioneve informative dhe edukuese, pasqyrimi

iveprimtarive kulturore, politike, ekonomike dhe sociale; pasqyrimi i veprimtarive sportive te vendit dhe te huaj, evente te ndryshme direkt etj.

2. RTSH 2 (HD)

Kanali i dytë gjeneralist me më shumë hapësirë për praninë e problematikave kombëtare dhe rajonale në ekranin e transmetuesit publik.

3. RTSH 3 (SD)

Kanali gjeneralist që do të vihet në dispozicion të pasqyrit të problematikave dhe interesave të bashkëkombësve dhe diasporës. Në të do të ketë programe të veçanta për edukimin, gjuhën, kulturën turizmin, biznesin. Fokusi i këtij kanali do të jete njohja e bashkëkombësve që punojnë dhe jetojnë jashtë kufijve shtetëror me politikën ekonomike, politike, kulturore dhe sociale të vendit si dhe njohja e shikuesve të vendit me problematikën, jetën, aktivitetet dhe punën e shqiptareve që punojnë dhe jetojnë jashtë kufijve.

4. RTSH Sport (HD)

Kanal tematik sportiv që do të pasqyrojë të gjithë veprimtaritë sportive me karakter kombëtar, europian dhe botëror.

5. RTSH Parlament (SD)

Kanal tematik që do të vihet në dispozicion të transmetimit të drejtpërdrejtë të veprimtarive të Kuvendit dhe evenimenteve të tjera të rëndësishme të politikës së brendshme, përfshi fushatat zgjedhore dhe asaj të jashtme, përfshi samitet ndërkombëtare.

6. RTSH Lajme (SD)

Kanal tematik i ndertuar vetem me lajme dhe emisione informuese. Në programet e tij do të jene ngjarjet e dites, kronika, reportazhe dhe lajmenga vendi, rajoni dhe bota.

7. RTSH Fëmijë 1 (SD)

Kanal tematik me programe të dedikuara për fëmijë të moshës parashkollore.

8. RTSH Fëmijë 2 (SD)

Kanal tematik me programe për fëmijet e moshës shkollore dhe të rinise.

9. RTSH Shqip (SD)

Kanal tematik i dedikuar krijimtarisë letrare, artistike, kinematografike dhe teatrore të institucioneve shqiptare, filma, teatro, seriale, opera dhe balet.

10. RTSH Jetë (SD)

Programe të dedikuara për mënyrën e jetesës, udhëtimet, turizmin, kuzhinën, veshjen, shëndetin dhe trupin.

11. RTSH Muzikë (SD)

Kanal tematik dedikuar krijimtarise muzikore te vendit dhe te huaj. Rendesit do ti kushtohet rubrikave dhe transmetimeve qe i sherbejne tradises kombetare, zhvillimit te tyre, ruajtjes dhe perhapjes dhe transmetimit te vlerave artistike, te folklorit etj.

12. RTSH Film dhe Dokumentar (HD)

Kanal tematik qe do te vihet ne dispozicion te transmetimit te kesaj gjinie te artit, ku do te perfshihen filmat shqiptare dhe te huaj, filmave artistike me metrazh te gjate dhe te shkurtër, dokumentareve.

Nga keto, 7 programe (4 HD dhe 3 SD) do te nisin transmetimin brenda muajit marsit 2017, ndersa programet e tjera (SD) brenda vitit 2017.

Neni 7

Programet aktuale te RTSH-se

RTSH ofron 2 programe kombetare transmetimi audioviziv analog (TVSH dhe TVSH2), 2 programe kombetare transmetimi audio (transmetimet ne Radio Tirana - Programin e pare, Programin e dyte), 1 program transmetimi audio ne gjuhe te huaja (transmetimet ne Radio Tirana - Programin e trete), 1 program transmetimi audio per bashkatdhetaret (transmetimet ne Radio Tirana - Programin e trete), 4 programe qendrash audiovizive rajonale dhe 1 program satelitor audioviziv (kanali satelitor - TVSH Satelit), te gjithë programe me karakter gjeneralist.

1. Radio Tirana 1

Kanali kryesor kombetar audio i transmetuesit publik me shtrirje dhe interes te gjerë. Struktura programore e ketij kanali eshte nje mozaik gjithepershires i jetes shqiptare, me programe cilësore artistike, politike, sociale, kulturore, sportive, shkencore dhe argëtuese, me qellim informimin, argëtimin dhe edukimin e audiencës se çdo grupmoshe. Ky kanal do te pasqyroje veprimtarite fetare dhe do te realizoje e transmetoje programe per pakicat shoqerore.

2. Radio Tirana 2

Kanali gjeneralist kombetar audio i transmetuesit publik qe do te vihet ne dispozicion te pasqyrimin te problematikave dhe interesave te te rinjve.

3. Radio Tirana 3

Kanali gjeneralist kombetar audio i transmetuesit publik qe do te vihet ne dispozicion te pasqyrimin te problematikave dhe interesave te bashkekombesve dhe diasporës. Ne te do te ketë programe te vecanta per edukimin, gjuhen, kulturën turizmin, biznesin. Fokusi i ketij kanali do te jete njohja e bashkekombesve qe punojne dhe jetojne jashte kufijve shtetëror me politikat ekonomike, politike, kulturore dhe sociale te vendit si dhe njohja e shikuesve te vendit me problematikat, jetën, aktivitetet dhe punën e shqiptareve qe punojne dhe jetojne jashte kufijve. Ne te do te transmetohen edhe programe audio ne gjuhe te huaja, anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, turqisht, serbo-kroatisht dhe greqisht per informimin e te interesuarve te huaj per zhvillimet ekonomike dhe politike te

Shqipërisë, njohja e tyre me kulturën, historinë, folklorin dhe muzikën, turizmin dhe qendrat arkeologjike të vendit tonë.

Programet e qendrave audiovizive rajonale, si RTV Korça, RTV Gjirokastra, RTV Shkodra dhe RTV Kukësi janë kanale rajonale audiovizive të transmetuesit publik me shtrirje të kufizuar në një rajon të caktuar. Fokusi i këtyre programeve do të jete trajtimi i temave kryesore të jetes së komunitetit vendas, larmi programesh për të gjitha moshat, gjinive të ndryshme audiovizive, për gatitja e emisioneve informative dhe edukuese, pasqyrimi i veprimtarive kulturore, politike, ekonomike dhe sociale me karakter rajonal, pasqyrimi i veprimtarive sportive të ekipeve rajonale dhe evente të ndryshme rajonale.

Bazuar në strukturat programore të miratuara me anë të vendimeve të KDRTSH-së, për transmetimet në këto programe, RTSH merr përsipër të ofrojë gjatë transmetimeve të saj:

- I. Programe që kanë të bëjnë me shkencën dhe teknologjinë. Këto do të trajtohen në dokumentarë të ndryshëm të cilët do të përqendrohen në zhvillimet shkencore teknologjike në vite, si dhe risitë e zhvillimeve aktuale në fushën e transmetimeve. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë rreth 6% të kohës së transmetimit, apo afërsisht 520 orë transmetimi.
- II. Programe që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Këto do të trajtohen me emisione të posaçme, me të ftuar të profesioneve të ndryshme, si sociologë, psikologë, punonjës social, drejtues teknike të sistemit parashkollor apo mësues të sistemit shkollor, prindër apo drejtues të niveleve të larta të institucioneve shtetërore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me politikën e zhvillimit dhe të edukimit të fëmijëve. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 10% të kohës së transmetimit apo afërsisht 870 orë transmetimi.
- III. Programe sportive për publikun duke u trajtuar në emisione të veçanta, transmetimi i evenimenteve sportive më të rëndësishëm dhe të të gjitha disiplinave sportive që organizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo atyre europene dhe botërore me interes të veçantë. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 9 % të kohës së transmetimit, apo afërsisht 780 orë transmetimi.
- IV. Transmetimi i dokumentarëve të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj, që trajtojnë tematikën të ndryshme social-kulturore (zakonet, traditat si shenjë identiteti, njohja e monumenteve të kulturës sonë, trajtimi i problemeve të ndryshme që hasin bashkëkombësit, emigrantët, minoritetet etj), historike, gjeografike, artistike. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 13 % të kohës së transmetimit, apo afërsisht 1100 orë transmetimi.
- V. Transmetime të muzikës simfonike, të festivaleve, koncerteve dhe recitaleve të ndryshëm, si dhe organizimi i konkurseve të ndryshme të muzikës popullore dhe asaj të lehtë. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 7 % të kohës së transmetimit, apo afërsisht 600 orë transmetimi.
- VI. Transmetimi i emisioneve të ndryshme me karakter ekonomik, duke pasqyruar situatën aktuale, si dhe elementë të kuadrit ligjor në vend, biznesin dhe sfidat e

VII.

- tij. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 12 % të kohës së transmetimit, apo afërsisht 1050 orë transmetimi.
- Transmetimi i emisioneve që trajtojnë zhvillimet e ndryshme në sektorin e shëndetësisë, dhënia e informacionit të duhur për sëmundje të veçanta dhe kujdesi që duhet në trajtimin e tyre. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 16 % të kohës së transmetimit, apo afërsisht 1400 orë transmetimi.
- VIII. Transmetimi i emisioneve kushtuar librit, ku do të trajtohen gjërësisht me anë të shkrimtarëve të ndryshëm, arti në shprehjen e fjalës nëpërmjet shkrimtarëve shqiptarë dhe të huaj, si dhe njohja e publikut me botimet më të reja. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 13 % të kohës së transmetimit, apo afërsisht 1150 orë transmetimi.
- IX. Transmetimi i emisioneve duke trajtuar problematikën dhe vështirësitë që hasin njërezit në nevojë dhe ata me aftësi të kufizuar dhe mundësitë që u duhen dhënë për integrimin e tyre në shoqëri. Në gjithë harkun kohor prej një viti programe të tilla do të zënë përafërsisht 14 % të kohës së transmetimit, apo afërsisht 1200 orë transmetimi. RTSH merr përsipër që në një edicion informativ të transmetuar gjatë 24 orëve, në RTSH 1 dhe RTSH 3, të bëjë të mundur marrjen e informacioneve nga personat me nevoja të veçanta shqisore, duke siguruar transmetimin simultan nga personat e aftë për të komunikuar me ata dhe që do të pasqyrohet në një kuadrat të veçantë në ekran.
- X. Transmetimi i programeve të ndryshme audio ose audiovizive në 7 gjuhë të ndryshme, anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, turqisht, serbo-kroatisht dhe greqisht për informimin e të interesuarve të huaj për zhvillimet ekonomike dhe politike të Shqipërisë, njohja e tyre me kulturën, historinë, folklorin dhe muzikën, turizmin dhe qendrat arkeologjike të vendit tonë.
- XI. Transmetimi i programeve të ndryshme audio ose audiovizive që kanë të bëjnë me vepra europiane, të cilat do të realizohen në mënyrë graduale duke marrë në konsideratë përgjegjësitë informuese, edukuese, kulturore dhe zbatimëse që ka RTSH ndaj publikut.

Neni 8

Botimet dhe shpërndarja

Përgatitja, botimi dhe shpërndarja e shtypshkrimeve e të paktën një reviste dhe një broshurë, me qëllim promovimin e emisioneve të ndryshme me njohjen e tematikave që do të trajtohen në to, promovimin e spektakleve që do të organizojë apo në të cilat do të jetë bashkëprodhuese, trajtimin e evenimenteve artistike dhe kulturore që do të realizohen në kuadër të përmbushjes së qëllimit për të cilin është krijuar.

Neni 9

Shpërndarja e materialeve audiovizive

Publikimi dhe shpërndarja e materialeve audiovizive të regjistruara, do të bëhet nga Drejtoria e Arkivës kundrejt tarifës së përcaktuar, me kërkesën e çdo personi që e paraqet atë me shkrim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së. Kërkesat do të trajtohen në

përputhje me parashikimet e neneve 14, 15, 16 e 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Neni 10

Pikat e transmetimit

Pikat e transmetimit, frekuencat dhe karakteristikat e tjera teknike të rrjetit numerik si dhe të rrjetit analog për transmetim audio që do të shfrytëzohet nga Radio Televizioni Shqiptar janë të përcaktuara saktësisht në Aneksin nr.1 që do t'i bashkangjitet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 11

Përdorimi i rrjetit numerik të RTSH-së

RTSH mund të ofrojë shërbime në të ardhmen, ku të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim, pas miratimit nga AMA, shërbime transmetimi lokale, rajonale, apo për kategori, ose grupime të ndryshme shoqërore, shërbime të cilat duhet të jenë të lira. RTSH dhe AMA marrin përsipër me anë të kësaj kontrate, që në rrjetin numerik kombëtar të RTSH-së, të mundësohet shfrytëzimi i këtij rrjeti për shërbimet me natyrë publike lokale, rajonale, apo për kategori ose grupime të ndryshme shoqërore, të cilat duhet të jenë të lira (free to air) dhe do të miratohen e do të përcaktohen si të tilla nga AMA.

RTSH dhe AMA marrin përsipër me anë të kësaj kontrate që të bëhet i mundur përdorimi i rrjetit të dytë numerik të RTSH-së nga operatorë të tjerë bazuar në kontratat dypalëshe të lidhura me RTSH dhe në bazë të tarifave të miratuara nga AMA.

RTSH merr përsipër me anë të kësaj kontrate, që, pas një këshillimi paraprak me AMA dhe kur konsiderohet e arsyeshme nga palët, të pranojë kërkesën e AMA-s për të bashkëpunuar me një operator të licencuar për transmetime audio ose audiovizive, për përdorimin e mjeteve të infrastrukturës së shpërndarjes së sinjalit, për shërbimet e transmetimit audio ose audioviziv të licencës përkatëse.

Tarifat hartohen bazuar në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato propozohen nga RTSH-ja dhe miratohen nga AMA, e cila shprehet brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimit. Nëse AMA nuk shprehet brenda këtij afati, tarifat konsiderohen të miratuara.

Neni 12

Detyrimet e RTSH-së

RTSH merr përsipër detyrimin e zbatimit të masave rregulluese dhe të kriterëve të përcaktuara nga AMA, për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së.

RTSH merr përsipër të paraqesë çdo vit një raport pranë AMA-s, në lidhje me mbulimin gjeografik dhe mbulimin e popullsisë me shërbim audioviziv.

RTSH merr përsipër garantimin e cilësisë së shërbimit, duke zbatuar kushtet dhe standardet teknike të përcaktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AMA dhe standardet ndërkombëtare mbi cilësinë e shërbimit.

RTSH merr përsipër të paraqesë çdo vit një raport në AMA mbi treguesit e cilësisë së shërbimit dhe mënyrën e mbledhjes së raportimeve/ankesave/sugjerimeve në lidhje me cilësinë e shërbimit.

RTSH merr përsipër të hartojë një plan lidhur me mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit në të cilin të përshkruhet mënyrat që do të përdorë operatori publik për zgjidhjen e problemeve teknike në rrjetin e transmetimit, kohën e parashikuar për zgjidhjen e tyre, procedurën që do të ndiqet për zgjidhjen e ankesave.

RTSH merr përsipër të paraqesë pranë AMA brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar një raport mbi prodhimet e porositura gjatë vitit të kaluar nga fondi i prodhimit të pavarur, emrin e shoqërisë ose personave të kontraktuar për këtë qëllim, përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur gjatë vitit të kaluar dhe shumën e mbetur pa u shpenzuar.

RTSH merr përsipër të paraqesë pranë AMA brenda datës 30 prill të vitit kalendarik, bilancin vjetor të vitit financiar.

Neni 13

Informacionet për personat me nevoja të veçanta shqisore

RTSH merr përsipër që në një edicion informativ të transmetuar gjatë 24 orëve, të bëjë të mundur marrjen e informacioneve nga personat me nevoja të veçanta shqisore, duke siguruar transmetimin simultan nga personat e aftë për të komunikuar me ata dhe që do të pasqyrohet në një kuadrat të veçantë në ekran.

RTSH merr përsipër ofrimin e shërbimit të teletekstit dhe titrimin e programeve informative të transmetuara gjatë 24 orëve.

Neni 14

Hapësira e Mbulimit

RTSH merr përsipër me anë të kësaj kontrate, që programet e saj kombëtare, në respektim të përmbushjes së qëllimit të saj në ofrimin e shërbimit të transmetimit audio dhe audiovizive për publikun, të mbulojnë territorin e banuar në Republikën e Shqipërisë sipas parashikimeve të nenit 121 të ligjit nr.97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 15

Amendimet e kontratës

RTSH dhe AMA bien dakord që në rast të një shtese me shërbime nga ana e RTSH-së, si në çeljen e kanaleve të reja, ashtu edhe në shtimin e transmetimeve të reja lokale apo rajonale, të miratuara paraprakisht nga Këshilli Drejtues i RTSH-së, të shprehen duke nënshkruar një shtesë kontratë në të cilën të jenë përcaktuar saktësisht karakteristikat teknike të transmetimit dhe struktura programore e tij e detajuar. Kjo shtesë kontratë do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontrate dhe do të ketë afat vlefshmërie deri në përfundimin e kësaj kontrate.

Neni 16

Raportimi për prodhimet e pavarura

RTSH merr përsipër që prodhimet e pavarura të programeve audiovizive përgjatë një viti financiar, të specifikohen saktësisht me të gjitha elementët e kërkuar nga neni 123 i ligjit nr.97/2013, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, dhe brenda 3 muajsh nga përfundimi i vitit financiar, RTSH do të paraqesë pranë AMA njëraport të detajuar për keto prodhime të pavarura, emrin e shoqërisë ose personave të kontraktuar për këtë qëllim, përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur gjatë vitit të kaluar dhe shumën e mbetur pa ushpenzuar, si dhe çdo çështje tjetër që lidhet me këto prodhime të pavarura brenda kërkesave të ligjit.

Neni 17

Mbikqyrja e kontratave të shërbimit mbi përdorimin e rrjetit numerik të RTSH-së

AMA ka të drejtën dhe detyrimin të mbikqyrë zbatimin e kontratave të shërbimit mbi përdorimin e rrjetit numerik të lidhura mes RTSH dhe transmetuesve të tjerë për transmetimin e programeve të tyre. AMA ka të drejtën e zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve pa cënuar të drejtat e tyre të sanksionuara nga ligjet në fuqi.

Neni 18

Frekuencat e transmetimit

RTSH dhe AMA bien dakord me anë të kësaj kontrate se shërbimi i programeve të RTSH-së do të mbështetet në rrjetet e transmetimit që do të kenë frekuencat e mëposhtme të miratuara nga AMA me vendimin e saj nr.27, datë 01.02.2013, që do të jetë Aneksi nr.2 i kësaj kontrate.

RTSH do të zbatojë të gjitha parametrat teknike të përcaktuar në këtë kontratë. RTSH do të lejojë zyrtarët e autorizuar nga AMA-s për të kontrolluar frekuencat dhe për të inspektuar ambjentet e transmetimit të RTSH-së, për të siguruar bashkëpunimin e nevojshëm.

Neni 19

Afati

Kjo kontratë do të ketë jetë e vlefshme nga moment i nënshkrimit të saj nga palët deri përnjë afat kohor prej 5 vjetësh, të përcaktuar si të tillënë nenin 117 të ligjit nr.97, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 20

Përfundimi i kontratës

Kontrata përfundon me mbarimin e afatit të saj të përcaktuar në nenin 19 të kësaj kontrate. Palët marrin përsipër detyrimin ligjor të përcaktuar në dispozitën e nenit 117 të ligjit nr.97, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, që 30 ditë para mbarimit të afatit të kësaj kontrate, të hartojnë dhe të lidhin një kontratë të re me afat të njëjtë.

Palët marrëin përsipër që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim dhe me bisedime, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21
Dispozitat e fundit

Kjo kontratë do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në fushën e mediave audiovizive, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.
Çdo term i papërkufizuar në këtë kontratë do të ketë të njëjtin kuptim si aktet ligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.
Aneksat e kontratës do të jenë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.
Kjo kontratë përpilohet në 21 (njëzetnjë) nene, në gjuhën shqipe dhe në 2 (dy) kopje origjinale nga të cilat palët marrin secila nga 1 (një) kopje.
Çdo njëra prej tyre ka përmbajtje dhe vlerë të njëjtë ligjore.

Palët

Për RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR
Drejtori i Përgjithshëm

Thoma GËLLÇI

Thomylli

Për AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Kryetari

Gentian SALA